



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|------------------------------|------------|-------------------|-------------------|
| Prireditor/Pratitja/Me Dantë | 19.08.2025 | | |
| Nr. Dokument Gj. Broq | Numri Broq | Subtopiq Udziq | Vlera Vrednost |
| 01- | 060/01- | 1125 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershori 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **VIII** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **25.08.2025**, (**e Hënë**) në ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për gjashtëmujorin e 2025 (janar-qershori 2025)**

Viti, më 19.08.2025

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E SHTATË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **21.07.2025 (e hënë)**, në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkyetar i komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i kuvendit komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, zn.Zejnepe Osmani, ndërsa mungoi: zn.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtoret e drejtive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përvendetje për nënkyetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtoret që janë prezent në këtë mbledhje dhe ju të tjerë pranishëm. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e shtatë të rregullt të KPF-së. Pra, materialin e keni marrë me kohë. Para se me hi në rend dite, hapi diskutim, nëse ka jasht rendit të ditës.

z.Ilir Zuka: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Para disa muajve e kam bërë një kërkesë. E di që nuk është kompentencë e komunës, por kam provu me u lidhë me regjion, dhe po deshke me bë një këkresë Drejtoria e Shërbimeve Publike për intervenime në rrugë, që është rruga magjistrale në Pozheran. Qendra në Pozheran është në gjendje shumë të keqe, dhe kam pas ankesa shumë që janë me të drejtë. Nëse ka mundësi Drejtoria e Shërbimeve Publike me inspektu rrugën edhe me ja dërgu një kërkesë ministries, kjo është me urgjencë.

znj.Majlinda Shabani: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Për rrugen rrëth lumi "Morava" që është e shtruar me kubza, më sa jam tu e pa është nis me punu një objekt banesorë, ja ka nis me rrjedh uji, dhe perpos kamionave që janë me tone të mëdha dhe shenja që parashihet, me sa tonë parashihet me kalu në atë rrugë, por edhe nëse i shef veturat tu ardh dhe kaosi që është tu bë në qytet, dhe e shef që shumica po mundohen me i ik asaj rruge. A ka me mbetë ajo rrugë ashtu a kan me u hekkë ato kubza komplet? Por ajo rrugë është jofunksionale, përpos pjesa e sheshit që është lidhë, që është bërë komplet shesh, që përmendimin tim ka qenë pa nevoj hiq, se nuk i vynë Komunës së Vitisë. Me pas gjithë atë shesh, nuk e di shesh më të madh as Gjilnai as Ferizaji nuk ka. Pjesën komplet qytetit çka ke pas me qarkullu e ke blloku. Pjesa rrëth lumi është blloku. E ke rrugen 2 kahje, ka ana e gorenjes dhe pejsa knej. Kjo rrugë është jofunksionale, nuk është tu shfrytëzu hiq, veq prej zorit. Unë duhet me marrë masa sa i përket asaj rruge ose veç me tregu që nuk e keni ndërmend me bë kurgja, dhe ka qenë një projekt që nuk është planifiku siç duhet. Ka qenë ashtu dhe në të mbetet ashtu.

z.Jakup Demiri: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Te këto rrugë që jan bërë 2 kahje, por nuk jan të kaluara prej kuvendit komunal, dhe është bërë një kohë e gjatë, por nuk kanë ardh në kuvend, dhe e dini që autoriteti për me ju dhanë rrugëve për këto kritere është asambleja komunale. Dua ta di cila është arsyaja që nuk vijnë në kuvend komunal. Dhe disa vende që u janë ndar taksistave. Edhe ata është dashtë me kalu përmes kuvendit, por as ato nuk janë bërë dhe kanë problem, dhe qytetarët se nuk i dinë vendet, mirëpo edhe te gjobat e policies, mendoj që është problem, se mundet me shku procesi deri në gjykata, dhe edhe policia mund ta humb si land. Kërkoi që me ardh në kuvend komunal dhe me i rregullu këto çështje.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Ilir, çështjen e di se, në

aspekt gojor kam qenë prezent kur është bërë kërkesë nga ana e kryetarit dhe drejtorit të Shërbimeve Publike, që me dalë me intervene, jo vetem rrugën në Pozheran, por në të gjitha rruget magjistrale. Besoj që së shpejtë kanë me rregullu këtë çështje. Majlinda, rruga me kubza është një realitet se është një joprofesionalizem i shtruarjes. Kemi pas shumë takime të cilat kompania nuk po bindet që ka dështu në shtruarjen e saj. Shumë qytete kanë rrugë me kubza, dhe nuk do të ishte problem që kalojnë kamionat, dhe krejt në përfundim, ka ardh që deri me 15 gusht mos me I ngucë për shkak mërgates mos me shkaktu tollovi, dhe më vonë ndoshta është telashe që duhet me i hekë krejt, dhe me gjëtë kompania një ekip profesional. Jakup, e ken grit një çështje shumë me vend, se nuk ka rrugë as parking që cakohen pa propozim vendim që vjen nga ana e ekspertëve, që ju propozohet kuvendorit, e kuvendi e miraton. Mirëpo, prej daljes në pension të inspektorit të komunikacionit, na ka mungu inspektori. Tash është pranu një, por kur ka me ja fillu punës nuk e di, por në momentin që ja fillon punës do ta marrë unë përsipër me drejtorin e inspepcionit me ardhë me ja propozou kuvendorit, që ta zgjidhim këtë çështje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, materialin e keni marrë, vazhdojmë me rend të ditës.

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2025

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendorit Komunal të Vitisë për vitin 2026.

4. Informatë nga DKA-ja, përfundimi i vitit shkollor 2024/2025.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për rend të ditës. Pasi që nuk ka: a jeni që të miratohet rendi i ditës? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendit i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e KPF-së

z.Jakup Demiri: Unë ja spjevoa sekretarisë për lëshimet që jan bërë në procesverbal.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Atëhere, e qes në votim: a jeni që të miratohet procesverbali me këto ndryshime? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershor 2025

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë për buxhet dhe financa: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Buxheti i aprovar për vitin 2025 në total për t'ë gjitha kategoritë ekonomike është 18 milion e 482 mijë 823.87 euro. Buxheti i alokuar për periudhën janar qershor 2025, për të gjitha kategoritë ekonomike është 11 milion e 658 mijë e 317.12 euro, ndërsa për 3 mujorin e dytë, për të gjitha kategoritë ekonomike është 10 milion e 795 mijë e 317.62 euro. Shpenzimet për kategorinë paga dhe shtesa është shpenzu 95.05%. Shpenzime në kategorinë janë shpenzu 90.63%, shërbimet komunale janë 85.25%, shpenzimet për subvencione 51.49% dhe investime kapitale 94.27%. Te pasqyrat financiare e keni të prezantuar edhe buxhetin e aprovar, të alokuar dhe shpenzuar për të gjitha programet buxhetore: Zyra e Kryetarit 75.99%, Administrata 91.55%, Inspeksioni 94.36%, Zyra e Kuvendorit 95.96%, Buxhet e Financa 94.28%, Shërbimet Publike 90.15%, Zyra e Komuniteteve 92.70%, Bujqësia 54.69%, Gjedzezia 89.38%, Planifikimi urban dhe mjedisi ka shpenzuar 98.58%, Shëndetësia 99.00%, Shërbimet sociale 94.66%, kultur rini dhe sport kan shepznaur 97.16%, arsim dhe shkenc 92.91%. të hyrat buxhetore komunal vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar qershor të vitin 2025 të hyrat e planifikuarara për vitin 2025 janë 1 milion e 270 mijë e 127 euro, të hyrat e planifikuar për perudhen janar-qershor 2025 janë 635 mijë e 63.50 euro dhe të hyrat e realizuar për periudhen janar-qershor 686 mijë e 846.21 euro, apo shprehur në përqindje realizimi, duke u bazuar në planifikimin 6-mujor është 108.15%, ndërsa duke u bazuar në planifikimin vjetor është 54.08%. Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor 2025

dhe të hyrat e periudhën janar-qershori 2024, të hyrat janë 686 mijë e 846.21, ndërsa të hyrat 2024 kanë qenë 480 mijë e 306.73%. D.m.th, të hyrat për vitin 2025 janë më të larta për 206 mijë e 539.48 euro. Prezantimi analistik i investimeve kapitale për periudhen janar-qershori 2025. Gjatë kësaj periudhe shpenzimet nga investimet kapitale janë 3 milion e 357 mijë e 523.34 euro, që i keni të paraqitur në mënyrë të detajuar në raportin që keni marrë, materialin, vlen të theksohet se, nga shuma totale 1 milion e 970 mijë e 523.34 euro, janë të ekzekutara nga Komuna e Vitisë për projekte që kanë punë të kryera në teren, dhe me situata të pranuara nga organi mbikëqyrës, ndërsa shuma prej 1 milion e 386 mijë e 683.81 euro janë shpenzimet e ekzekutuara nga thesari i shtetit, e që këto shpenzime janë obligime të viteve të mëhershme, që rrjedhin nga kontrata kolektive. Dhe në fund e keni të prezantuar kahasimin e shpenzimeve për periudhën janar-qershori 2025, me të njëjtën periudhë të vitit 2024, shpenzimet e vitit 2025 në krasim me shpenzimet e vitit 2024 janë më të ulta për 866 mijë e 406.84 euro. Kjo ishte në pikë të shkurta. Për çdo pakjartësi ose pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Jakup Demiri: Drejtoshë, nuk është e zakonshme prej pasqyrave tjera, prej viteve tjera, për shkak borgjeve, d.m.th, ekzekutimi është diku 92%. Po sa janë realizu të planifikume për këtë vit, edhe nga obligimet e kalume sa janë dëmtu kompanitë që kanë punu aty? Faktura sa kanë mbetë, d.m.th plus obligimet e mbetura. Sa prej qetyne, se ndoshta ka qenë mirë me cekë në pasqyra financiare që, nga ky realizim kemi edhe faktura të pa paguara të sivjetit, për shkak që kemi pas obligimet me çështjen e kotrates kolektive, me ditë ne që sa obligime prapë kemi, se pjesa më e madhe besoj që për shkak natyrës që ka qenë vitit të kalume, që kanë paditë, e kanë dëmtu buxhetin, dhe tash sa prej tyre na mbetin tash, se ne kemi veç realizimin 92%. Mendoj që një pjesë e madhe nuk janë pagu. Dhe te bujqësia: pse është vetem 54% i realizum deri tanë?

znj.Majlinda Shabani: Fillimisht po krijoitet një pakjartësi. Ekzekutimi i buxhetit është diku 92%, vendime gjyqësore i ke diku gjysëm milioni, po përpos kësaj, unë qka kam arritë me pa dhe që jemi tu e pa te prezantimi analistik i investimeve kapitale i ke 7 emërtime që janë vendime gjyqësore që janë tek investimet kapitale. Sugjerimi im, dhe nuk po besoj që është mirë, që vendimet gjyqësore, në këtë rast që e dimë që, kontrata kolektive ku po figuron, dhe këtu e që kalon shumën 1 millionshe, e që është shumë më shumë. Pyetja ime është: a ndërlidhen ato vendimet gjyqësore që janë paraqitura tek pasqyrat financiare, edhe me këto që janë të prezantimi analistik i investimeve kapitale? Dhe unë po konsideroj që, nuk është e mirë që me figuru tek investimet kapitale vendimet gjyqësore. Investimet kapitale e dimë çka janë, dhe nuk duhet me qenë tek vendimet gjyqësore, dhe është mirë që, në rast kur kemi vendime gjyqësore millionshe, pak a shumë me ditë se prej ku janë marrë ato mjete financiare që e kanë pamundësu një projekt apo investim pa përfundu, për shkak të pageses që është dashtë me bë për vendime gjyqësore. Mendoj që është mirë edhe qytetarët me pa që, për shkak ne kemi planifiku me bë një investim, po kanë qëllu vendimet gjyqësore që e dimë që, as nuk të pyesin se ku me i marrë mjetet, po veç i terhekin dhe pamundësohen një investim kapital me përfundu. Edhe tek kodet buxhetore po ti tregoj, dhe besoj që në seancë na përcjell: 13430 shërbimet e ndryshme shëndetësore, 13440 shërbime këshilldhënëse profesionale, 13460 shërbime korrektuese tjera, 14032 mirëmbajtaj rrugore lokale. Kisha kërku në këtë rast edhe prej drejtoret me na bë një lloj liste ose punët që janë bë se ku janë tu u mirëmbajt ato rrugë, se realisht kur del me pa punën në teren, jemi tu e pa që këto mjete financiare nuk jan tu shpenzu për mimbajtejn e rrugëve lokale. Kodi 14022, mirëmbajta e ndërtesave afarsite. Pasi nënkyetari është këtu, e kemi diskutu edhe më herët, kontratat që janë lidhë gjysmëmillion, gati për këto shërbimet këshilldhënëse profesionale, përpos që kam konsideru që ka qenë ndoshta një kontratë e panevojshme, nuk e di se qysh është vlerësu, dhe si pasoj ose si nevojë çka ju ka ardh. A është bërë me ndonjë rekomandim të ndokujt apo si po funksion kjo punë? Edhe përpos kësaj, këto shërbime që janë tu i dhënë, janë tu shpenzu mjete financiare kaq shumë. Ku janë tu u realizu në fund dhe cili është rezultati i tyre? Çka janë tu marrë prej këtyre njerëzve që janë tu pagu me mijra euro për me marrë shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, se nëse del me i pa projektet e punët që janë tu bë në komunë, aspektet ligjore ne e dimi që kemi lisitat që kanë qenë tash e sa kohë në komunë tu punu, por po du me pas arsyetimin e këtij shpenzimi që është tu bë. Është absurde me bë një shpenzim diku 232 mijë euro për 6 muj, me pagu dikënd me të dhënë shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Dhe në fund: ku janë tu figuru ato shërbime, dhe çka janë tu i shërby qytetit të Vitisë dhe qytetarëve? Për mua kjo është pak absurde dhe pa kuptim. Nuk po ma arsyeton kruqysh logjika.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne e dimë që buxhetin kur ta merrë nga vendimet gjyqësore nuk të vetë, ta merrë kodin ku ka pare. Ne kemi diskutu me herët që, vendimi gjyqësor nuk është investim kaptial, por nuk ka qare pa u shënu, për shkak që u marrë prej të njëjtë kod, mirëpo më interson që ka shumë projekte që na ka penalizu

për me realizu marrjen e parave. A është tu kry punë me qeto nënkyetar apo kanë mbetë ato punë? Se tash çdo punë që kryhet me pare që janë marrë, komuna hynë në borxh. Nëse hymë në borxh, ne rrezikojmë me bë punë vitin e ardhshëm, që është një sfidë për vitete tjera. Ligjërisht ne nuk kemi drejt me hy borxh dhe me punu më shumë se që kemi pare. Cila është gjendja, në këtë aspekt a janë tu punu firmat apo kemi mbetë sa kemi pare? E kuptoj që këtë vit kanë mbetë projekte pa u realizu, për shkak parave që janë marrë, se paret e veta nuk i shtinë askush me ta kry punën, mirëpo ka edhe firma të forta që munden me shti, mirëpo ai çdo punë që e kryen është obligim i komunës për të ardhmen.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Jakup, tek bujqësia 54%. Me siguri tash janë çështja e ndarjeve të subvencioneve dhe bahet pagesa, prandaj për atë është 54%. Besoj që në muajin e 7-të do të dalin, se e di që komisioni ka punu në përzgjedhjen e tyre që janë përfitues, dhe në momentin e ekzekutimit apo prurjes së atyre veglave çka janë, bëhet ekzekutimi. Majlinda, me kryesuesin pat si të njëjtë pyetjen. Nuk mund Majlinda, se nga aty ku i merr ti e shënon investim kapital, dhe besoj që në ato kartealat analitike që i kanë në drejtori me shku krejt investimet që bahan aty i gjenë se sa janë shku në investime kapitale, sa jan marrë prej investimeve kapitale që janë ekzekutu si vendime gjyqësore. Unë do t'i themë drejtorit. Unë besoj tek çështja e mirëmbajtjes së rrugëve lokale ta kemi parasysh që, përvëç mbushjes së gropave, pastrimi nga bora, pastrimi nga barrojat, krejt hynë në këto te mirëmbajta e rrugëve, sa dhe cilat, në cilat është intervenu. Besoj që ai e ka dhe me kilometra. Në rast se ju jeni të intersum, muj me i thanë që, përgatite një listë prej janarit deri në muajin e 6-të, se në cilat vende janë bë intervenime për mbushje të gropave, barrojat, bora. Tek çështja e fundit që pyeti kryesuesi. Është e vërtet që jemi në pozicion të palakmueshëm, se ato kanë shku vazhdimisht prej vitit në vit, se që 3 vite kjo ka fillu. Është e vërtet që disa kompani të cilat kanë potencial të vetin ekonomik, që nuk varen shumë nga mjetet të cilat ne i quesim, ato po vazhdojnë me punu, për shkak që kemi lidhë kontrata me një formë. Ai ti merr, dhe shumica e kompanive e kanë të lidhë kontratën, por disa kompani që nuk kanë potencial të vetin financiar, ato janë ndal dhe po pushojnë, për shkak që edhe informacionet ja japid atje për mrekulli qysh tek ne bisedojmë. Takim këtu atje, ju thojnë mos ja nis se paret ja marrim, deportojnë, se si nuk e di ka i marrin ato informacione, dhe besoj që borxhet do të barten dhe në vitin 2026. Sa do të jenë ato, a do të vijë një vendim i qeverisë, se nuk është problem vetëm i Komunës së Vitisë, edhe pse drejtoreshën e kemi ladhë tu i thanë bëni kérkesë për rimbursim. Nëse qeveria bjen një vendim, do të ishte forma më e mirë me mbulu krejt Republikën e Kosovës, shkon me pagesa dhe puna i kthet normalitetit. Por, a do të bëhet, nuk kam informacione të tilla. Vitin e kalum e di që pak na kanë rimburzu, nuk e di sakt sa, por vetëm pak e di. Si do të bëhet në këtë vit, besoj që konstituimi të bëhet sa më shpejt në nivel të Republikës së Kosovës, do të merr edhe kahjen. A do të thotë po apo jo, këto ngritën në muajin e fundit, në ato kohë e bëjnë një shpërndarje, por ajo shpërndarje nuk i mbulan krejt kontratën kolektive, se e di që rregullisht i thirrin kryetarët, qoj kaq kérkesa, kaq ti mbuloj, jo në tërësi sa na kanë humb. Unë krejt do t'i kisha pranu, veç tek investimet kapitale dhe te shërbimet dhe mallrat nuk është mirë me demtu.

znj.Milihat Ajeti, drejtoreshë për buxhet dhe financa: Majlinda dhe Jakupi që pyeten, sa obligime kemi. Tani pa pagu janë 933 mijë e 614 euro, janar-qershori kemi obligime, mirëpo i kemi të hyra vetanake dhe kemi mjete hala që nuk kemi guxu me i liru puna derisa të përfudon, se nuk na kanë qu listën thesari, se ku ka me i marrë përmbaruesi, ku nuk ka me i marrë. Mandej, ne nuk mundemi me ekzekutu, se ashtu edhe për 2 javë e kemi kodin e të hyrave vetanake 22 që e kemi të myllt. Majlinda, shpenzimet kapitale na kanë marrë 1 milion e 400 mijë, mallra, shërbime 573 mijë, shpenzimet komunale 4163 dhe subvencione transefere 61 mijë e 512 euro. Veç këtë vit sa na kanë marrë, kurse rimburismi nuk ka qenë rimbursim nëpër kode të caktuara, veç pagat. Pagat i ka marrë, ato i ka kthy. Nuk është rimbursim për mendimin tim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit! A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në kuvned.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2026

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne në kuvend e kemi votu komisionin, parmisht 90% është plani i njëjtë si paraqitet, por një vendim i kuvendit na duhet për me dalë në diskutim publik. Tash drejtorit, d.m.th me

Irrëgulloren e re i qesin vetë në diskutim publik, nuk kemi në kuvend, por pasi është plani i kuvendit, ne duhet me vendim të kuvendit me u diskutu nëse ka interesim, edhe me u miratu. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvned? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë vot kundër, asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Informatë nga DKA-ja, përfundimi i vitit shkollor 2024/2025

z. nj. Arta Ajeti, drejtoreshë e DKA-së: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Mësimi për vitin shkollor 2024-2025 ka përfunduar në të gjitha shkollat me datat e parpara nga kalendar i MASHT-it, sipas udhëzimit administrativ që kemi 04-2024, me datën 27.08.2024 për vitin shkollor 2024-2025 në arsimin paraunivesitar. Përfundimi i vitit sipas niveleve shkollore. I kemi klasat 1-8, ku përfunduan mësimin me 23.06.2025. Nxënësit e klasave 1-5 përfunduan vitin me notë mesatare 4.23, nxënësit e klasve 6-9 përfunduan vitin me notë mesatare 3.41, klasat e 9, 10, 11 përfunduan mësimin me -5/-6/2-25. Nxënësit e klasave 10-12 përfunduan mësimin me notë mesatare 2.88, por vrehet që është një sfidë, por do të jemi pak më afér shkollave vitin e ardhshem, për shkak se nota mesatare është më e ulët se vitin e kaluar. Klasat e 12-ta përfunduan me 15.05.2025. Këtu kanë pas hapësirë që të përgatiten edhe për testin e maturës. Gjatë këtij vitit janë mbetur testet të jashtme, ndërkomëtare që kemi pas testin PISA, testin e maturës dhe testin e arritshmërisë. Organizimi i këtyre testeve është kryer nga Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me shkollat dhe MASH-tit. Testi i maturës në Komunën e Vitisë për vitin 2024-2025 është mbajtur me 23 qershori 2025, ku u paraqiten 295 nxënës maturant. Nga ata, 201 nxënës kaluan testin, ndërsa 94 jo, por e kanë edhe një test në fund të gushtit. Testi arritshmërisë është mbajt me 27.06.2025 për vitin shkollor 2024-2025, ku në këtë test morren pjesë 520 nxënës të klasave të 9-ta, me mesataren aritmetike të pikëve 46.5. Në këtë kohë sipas udhëzimeve të MASH-tit janë hapur konkurse për regjistrimin e nxënësve në parafillor, 5-6, në klasën e parë dhe klasen e 10-të. Po ashtu edhe është zhvillu konkurs publik për pranimin e fëmijëve në çerdhe te "Gëzimi Ynë" dhe paralele të ndara. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtë dhe trajnime që kemi pas nga ana e SBASHK-ut, dhe aktivitetet e ndryshme, përfshir edhe olimpianden e përbashkët të Gjuhës Shqipe, Matematiken kangaroo dhe aktivitetet tjera përmes OJQ-ve, ku janë realizuar edhe fusha vetëdijësuse nga organizata të ndryshe. Vlen të ceket dhe bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, me ligjëratë vetëdijësuese dhe dukurive negative në shoqëri. Po ashtu fal punës së psikologëve janë trajtuar raste të shumta nëpër shkolla, dhe ekzistojnë raporte mujore për punën dhe angazhimin e tyre. Po ashtu ju njoftojmë se bursat për studentë janë përfunduar për vitin akademik 2024-2025, janë procesuar në pagesë. Tash jemi dhe në fazën e renovimeve të objekteve shkollore, duke u përgatit për një fillim të ri të vitit shkollor 2025-2026.

z. Ilir Zuka: Drejtoshë, duke të uruar më të mirat në jetë për ty, për shkak që e dimë që në kohen e fundit keni kaluar një sfidë, tash e tutje urojmë më të mirat. E pash në material që më ka shqetsu kjo nota mesatare, ku pritet taman fëmija me marrë pjekurin, d.m.th klasa 10 deri 12, që është 2.88, që e kam vërejt si shqetësim. Dhe tetra, a keni bë një përbledhje, sa është në ramje numri i nxënësve prej viteve paraprake.

z. Jakup Demiri: Drejtoreshë, i bashkngjitem dhe unë llirit, dhe besoj që të vazhdën si është më së miri mos të perseriten më. Sa i përket raportit të drejtorisë, më duket i vogël, se në raport duhet me pas, se cilat shkolla kanë me u rinovu. A i keni koordinu punët që të kryhen punimet sa është koha, që nxënësit nuk janë aty? A i keni të identifikuara disa shkolla, se unë kam dalë në teren, sidomos në muajin maj kogjo një pjesë. Nëse nuk gaboj, janë 7 shkolla që pikin, dhe kjo arritshmëria e nxënësve të klasës 10 deri 12, me notë mesatare 2.88. A kemi pas kontakte, d.m.th takime me drejtorët e këtyre shkollave? Se po besoj që disa shkolla janë shumë keq. Nota mesatare në përgjithësi është më e vogël se viteve të tjera. Tek testi i arritshmërisë, mendoj që komuna jonë mirë paska qenë. Raporti është i mangët me informata, të cilat neve na duhen. Përveç kësaj statistikës që është aty, është shumë i shkurt, këtu nuk ka një raport se sa ka probleme, se kemi ndëgju përmes msimdhënësve, që ka pas probleme. Dhe çka është bërë me ato raste? A keni ndonjë informatë për ndonjë mësimdhënës që sillet në mënyrë agresive dhe maltreton nxënësit. A keni shifër prej drejtorive të shkollave: sa kanë qenë gjatë vijueshmërisë, se nxënësit që kanë pas gripe të ndryshme, apo si ka qenë gjendja shëndetësore e nxënësve, sidomos në kohën e dimrit dhe sa mungesa kanë? Kjo me shty që me pas një kontroll të mjekëve nëpër shkolla. Kam parë dokument të komunave të tjera që i kanë këtu të cekta, mirëpo tek kjo infomatë e jona na duhet

inforamata shtesë, që me ditë mandej se sa prej shkollave nuk kanë dhe sa kanë ujë të pijshem.

zpj.Arta Ajeti, drejtoreshë e DKA-së: Ilir, për numrin e nxënësve nuk mund të themë për momentin që është sakt, se për arsyen ende nuk është bërë regjistrimi i kompletuar, që është sistemi SMIA. Posa përfundon, do ta qes edhe në kuvend. Sa i përket informatës, Jakup, informata është vetëm sa për informim, ndërsa raportin e kam tek raporti i kryetarit. Aty janë edhe vijueshmëria e nxënësve, mësimdhënësve dhe mungesave. Sa i përket shkollave që po pikin, tani jemi në renovim të objekteve, por me aq sa kemi kapacitet dhe mundësi, për arsyen se, e dimë se jo vetëm komuna jonë, por pothuajse të gjitha komunat janë tu ballafaqu me mungesë të mjeteve, për shkak të përmbaruesit. Në ato shkolla ku ka nevojë kuptohet. Thuaçje në të gjitha shkollat ka nevojë, nga pak intervenojmë, por në ato shkolla ku janë më të fokusuara dhe më të dëmtuara do të mundohet që të interevenoj aty, ndërsa sa i përket punës së shëndetësisë, ne kemi bashkëpunim me QKMF-në në Viti dhe thuaçje përedo vit kemi kontrolla sistematike nëpër shkolla. Jo vetëm kontolle shëndetësore, por kemi dhe stomatolog, oftomatolog, ku e bëjnë thuaçje tek të gjithë nxënësit, ndërsa jo me i përfshi të gjitha shkollat, po ato ku kemi me numër më të madh të nxënësve, por më shumë, edhe me të thënë të drejtën në vendet rurale ju kemi dhanë hapsirë për shkak se këtu i kemi qendrat më afér shtëpisë së shëndetit, ndërsa vendet rurale i kemi më në periferi. Sa i përket 7 shkollave që pikin, e di që në kuvendin e kaluar keni bërë pikërisht ju Jakup pyetje, tash do të tentoj ti shof sa kam hapësirë buxhetore me intervunu nëpër shkolla. Iliri bëni pyetjejn e përqindjes së notes mesater të nxënësve, që siç e dini, në shkollën e mesme "Kuvendi i Lezhës" e kemi pas në renovim. Nuk po arsyetohem në atë aspektin se ka pas hapësirë edhe te shkolla "Bafti Haxhiu". Po ashtu dhe tek shkolla e mesme teknike "Jonuz Zejnullahu" mundet me qenë edhe ajo që nuk kishin objekt të tyre. Tash e tutje do të jemi më afér, më shumë të përkushtuar. Po ashtu përpos drejtoreve do ta kemi takimin me nxënësit, edhe pse puna tyre nuk ka munguar, ndërsa sa i përket mungesave të nxënësve, do ta paraqes kur është raporti i kryetarit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Si informatë ne e dimë që, dallon përfundimi i vitit mësimor dhe shkollor. Tash jemi tu fol për përfundimin e vitit mësimor, se viti shkollor përfundon me 31 gusht, sepse përfshihet edhe afati i provimeve dhe mbylljet procesi. Mëndoja që në këtë raport nuk është dashtë me i përfshi disa problematika tjera, se është për përfundim të procesit mësimor. Po unë mendoja që është dashtë të përfshihet edhe numri i nxënësve të këtij viti dhe numri i mungesave, se është problemi më shqetësues. Për mua mesataraja është shumë e mirë. Pra, a jeni që të shkojë kjo pikë në kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnje votë kundër, asnje apstenim. Faleminderit për kontributin! Shihemi në mbledhjet tjera!

Mbledhja përfundoi në ora 10:45

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi

| | | | |
|-------------------------------|------------|-------------------|-------------------|
| Prihvatu-Primjeno Me Datan... | 19-08-2025 | | |
| Nr. Izdajanti | Nomer Broj | Shtopje Period | Vlera Vrednost |
| Org. Broj | | | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opština Vitina-Municipality of Vitina



ZYRA E PROKURIMIT

Për: Komitetin për Politikë dhe Financa

INFORMATË E PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA PËR GJASHTËMUJORIN 2025

(JANAR-QERSHOR 2025)

Gusht 2025

Kjo informatë është përgadit për KPF dhe ka të përbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve,zhvillimin e punëve dhe furnizimeve që janë domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotsimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtjes pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara në interes të komunitetit dhe mirëqenjes qytetare në përgjithësi, këto aktivitete Zyra i zhvillon, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e prokurimit ka përgaditur këtë Informatë për aktivitetet e prokurimit 6 mujor për vitin 2025, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër, ku përfshihen në ketë nëntëmujor.

Në gjashtë mujorin e vitit 2025, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese zyra ka inicuar 31 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna;

12 aktivitete me lënde prokurimi Shërbime,

1 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe

18 me lëndë prokurimi Furnizime.

Nga këto aktivitete, 20 janë permbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon:

17 raste është përdorë procedura e hapur,

12 raste procedura e kuotimi i çmimit,

2 aktivitete procedurë me Vlera minimale, dhe

Prej këtyre aktivitetave të zhvilluara: 20 aktivitete të prokurimit, janë përmbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa; **11** aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm.

Zyra e prokurimit përveç këtyre aktivitetave ka nxjerr Urdhërblerjet për Operatoret Ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është **2,748,928.94 €**.

Gjithashtu duhet potencuar se Zyra e prokurimit në nëntëtë mujorin e parë, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi.

Menaxheri i zyrës së prokurimit



Fadil ABAZI ,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Komuna e Vitisë
Opstina Vitina-Municipality of Vitina



RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Form neniit 87.2.9.12 të Ligjit Nr. 04/L042, Ligji për Prokurimin Publik në Ko

Data e përgatitjes së raportit:

31.12.2025

Viti fiskal

2025

PJESA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

| Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues | | KOMUNA E VITISE | |
|--|--|---------------------------|-------------|
| Lloji i Autoritetit Kontraktues (zgjidhëne njëren) | | | |
| Kodi buxhetor | | Vi657 | |
| Adresa | | Viti, rruga "28 Nëntori" | |
| Kodi postar - Qyteti | | 61000 Viti | |
| Tel. fiks/ Celulari/Faksi | | 0280/381 519 | 044 505 984 |
| Emri i menaxherit të prokurimit | | Fadil ABAZI | |
| E-mail adresë | | fadil.n.abazi@rks-gov.net | |
| Adresa e webit të AK | | kk.rks-gov.net/viti/ | |

PJESA II . KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

| Nr.i Prokurimit | Numri rendor i prokurimit | Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e nënshkrimit të kontratës | Vlera e parashikuar e kontratës (zotimit) | Gjimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj. | Emri i OE të cilët i është dhënë kontrata | Selia e OE të cilët i është dhënë kontrata | | | | |
|-----------------|---------------------------|--|---------------------------------|---|--|---|--|------------------------|--------------------------|-----------------------|----|
| | | | | | | | OE vendor (1) ; jo vendor (2) | Atati kohor normal (1) | Atati kohor i shkuar (2) | Kritéri | |
| 2 | | Numri prokurimit ne sistem | 3 | 4 | 5 | 6 | | | | | |
| 001 | 064 | Lloji i prokurimit | 2 | 2 | 1 | 93 | 7 | 9.00 | 10.00 | 11 | 12 |
| | | Vlera e prokurimit | | | | | 28.02.2025 | 780,000.00 | 708,328.00 | KOSOVA MED HEALTHCARE | |
| | | Furnizim me dokumenta bllanko-Bllloka participi - Bashkepagesat ,recetat e barnave , vertetimet ,raportet etj | | | | | 02.05.2025 | 10,500.00 | 9,579.65 | EURO PRINT GROUP | |
| | | | | | | | | | | | |
| 002 | 272 | Furnizimi me dokumenta bllanko-Bllloka participi - Bashkepagesat ,recetat e barnave , vertetimet ,raportet etj | 1 | 2 | 1 | 21 | | | | | |
| | | | | | | | 23.04.2025 | 60,000.00 | 67,343.50 | EUROBAU COMPANY | |
| | | | | | | | | | | | |
| 003 | 397 | Furnizimi,montimi dhe rregullimi me material te imët dhe pajisje te tjera për të gjitha njësit shpenzuese | 1 | 2 | 1 | 31 | | | | | |
| | | | | | | | 06.02.2025 | 700,000.00 | 700,000.00 | C.I.K. CARITAS | |
| | | | | | | | | | | | |
| 004 | 593 | Shërbimet e Kujdesit social dhe shëndetësor shtëpiak - palliativ i të sëmuarve në Komunën e Vitisë | 2 | 1 | 1 | 93 | | | | | |
| | | | | | | | 03.06.2025 | 15,000.00 | 13,965.00 | TV LLAPI | |
| | | | | | | | | | | | |
| 005 | 1029 | Shërbimet e ndriçimit profesional, binës, akcesorëve dhe zërimit për nevoja e Autoritetit kontraktues | 2 | 2 | 1 | 93 | | | | | |
| | | | | | | | 28.05.2025 | 253,350.00 | 253,350.00 | NTP HAXHIJAH SH.P.K | |
| | | | | | | | | | | | |
| 006 | 1466 | Furnizim me mekanizëm bujqësor | 1 | 1 | 1 | 29 | | | | | |
| | | | | | | | 26.06.2025 | 140,000.00 | 125,000.00 | KASTRIOTI SM SHPK | |
| | | | | | | | | | | | |
| 007 | 1454 | Furnizim me serra 50m2 | 1 | 1 | 1 | 29 | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|-----|------|---|---|---|----|--|------------|------------|------------|-------------------------------|-------|
| | | | | | | | | | | | |
| 008 | 1468 | 1 | 2 | 1 | 29 | Furnizim për Bletari; Fletë dylli dhe Koshere tre katëshe | | 21,600.00 | | | |
| 009 | 1584 | 2 | 2 | 1 | 93 | Mirëmbajtja e ndriçimit publik | 23.04.2025 | 51,000.00 | 3,050.10 | PLUS TRADE LLC | 1 1 1 |
| 010 | 1780 | 1 | 1 | 1 | 33 | Furnizimi me barna për nevojat e QKMF-s | | 272,000.00 | | OSHP | 1 1 1 |
| 011 | 2178 | 1 | 2 | 1 | 17 | Furnizim me rekuizita sportive për nevojat e Drejtorisë së Sportit dhe Drejtorisë se Arsimit | 13.05.2025 | 24,500.00 | 18,767.50 | INFINITT SHPK | 1 1 1 |
| 012 | 2718 | 1 | 2 | 1 | 28 | Furnizim me material higjenik | 18.06.2025 | 47,000.00 | 25,600.00 | LANTI PLAST SHPK | 1 1 1 |
| 013 | 2950 | 5 | 2 | 1 | 45 | Ndërtimi i tribunave të stadiumit në fshatin Skifteraj | 11.07.2025 | 35,000.00 | 32,680.00 | GOP. RIZAH AVDIU & RIZAJET K. | 1 1 1 |
| 014 | 3218 | 1 | 2 | 1 | 28 | Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit | | 100,000.00 | | Procedurë | 1 1 1 |
| 015 | 3721 | 1 | 3 | 6 | 93 | Furnizimi me videoprojektor, dhe riparimi të rrjetit të altoparlantave në sallën e koncerteve - kinemasë | | 3,000.00 | | ANULIM | 1 1 1 |
| 016 | 3962 | 2 | 3 | 6 | 93 | Sigurimi i automjeteve të komunës së Vitisë | 10.06.2025 | 9,950.00 | | Euro SIG | 1 1 1 |
| 017 | 4309 | 1 | 3 | 6 | 40 | Furnizimi me oksigjen medicinal për pacientë që kanë nevojë per sëmundje aspirative | | 3,000.00 | | ANULIM | 1 1 1 |
| 018 | 4553 | 2 | 2 | 1 | 93 | Mirrmbajtja e fotokopjeve dhe printerave dhe Furnizimi me tonera per shkolla | | 20,000.00 | | Procedure | 1 1 1 |
| 019 | 5064 | 1 | 4 | 7 | 28 | Furnizimi dhe montimi i laurës (rampës) automatike | 13.08.2025 | 990.00 | 980.00 | TOREX GROUP | |
| 020 | 5164 | 1 | 1 | 1 | 01 | Furnizim me dru zjarri për djegje për të gjitha njësítë shpenzuese të Autoritetit kontraktues, trevjeqar | 21.07.2025 | 544,760.00 | 543,620.00 | NTP. DARDANI. | 1 1 1 |
| 021 | 5190 | 1 | 1 | 1 | 33 | Furnizimi me reagencia për laborator-për Analiza- tre vjeçar | 11.08.2026 | 225,000.00 | 224,900.19 | BIO LAB SHPK | 1 1 1 |
| 022 | 5293 | 1 | 3 | 6 | 02 | Furnizimi me pelet për QMF në Pozheran dhe shkollën në Sadovinë | 15.08.2025 | 4,400.00 | 4,625.00 | BEK FLUIDS | 1 1 1 |
| 023 | 5434 | 2 | 3 | 6 | | Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtja e aparatave te Rëntegenit | | 6,000.00 | | RI-TENDER | 1 1 1 |
| 024 | 5838 | 2 | 2 | 1 | 60 | Shërbimet e transportit me autobus për nevojat e Autoritetit kontraktues | 15.08.2025 | 16,000.00 | 16,000.00 | VITIA TRANS | 1 1 1 |
| 025 | 5902 | 2 | 3 | 6 | 28 | Shërbimi me tenda 2 ditor, montimi dhe sigurimi i tyre për Panairin tradicional të Bujqësisë | 06.08.2025 | 1,550.00 | 1,140.00 | RIZAH AVDIU B.I | 1 1 1 |
| 026 | | | | | | Vlersimi i mbrojtjes nga rrezatimi ne Repartin e Diagnostikes ne kuader te QKMF-s ne Viti | | 920.00 | | | 1 1 1 |
| 027 | 5996 | 2 | 3 | 6 | 29 | Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtja e aparatave te stomatologjisë | | 5,000.00 | | | 1 1 1 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|-----|------|---|---|---|--|--|----------|--------------|--------------|--|--|---|---|---|
| 028 | | 1 | 3 | 6 | Furnizimi me ditar shkollar | | 5,000.00 | | | | | 1 | 1 | 1 |
| 029 | | 1 | 3 | 6 | Furnizim me material zyrtar dhe pedagogjik për procesin mesimor (Shkumsa,shpuza liber amë, mjete te tjera didaktike etj) | | 5,000.00 | | | | | 1 | 1 | 1 |
| 030 | | | | | Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme Lot I.Transporti i nxënësve Letnicë-Stubëll e Epërme dhe anasjelltas | | 8,100.00 | | | | | 1 | 1 | 1 |
| 030 | | | | | Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme e Lot II.Transporti i nxënësve Podgorcë-Viti, dhe anasjelltas. | | 6,490.00 | | | | | 1 | 1 | 1 |
| 031 | 7511 | 2 | 4 | 7 | Vlerësimi i mbrojtjes nga Rrezatimi neë Repartin e Diagnostikës Radiologjike eë kuadër të QKMF-s në Viti | | 920.00 | | | | | 1 | 1 | 1 |
| 032 | | | | | | | | | | | | 1 | 1 | 1 |
| 033 | 5502 | | | | | | | | | | | 1 | 1 | 1 |
| 068 | | | | | TOTALI (10+11) : | | | 3,376,030.00 | 2,748,928.94 | | | 1 | 1 | 1 |

